



# Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

**KUMTESË PËR MEDIA  
7 SHTATOR 2018**

## **#DrejtësipërDonjetën**

Të hënën me 10 shtator, në ora 9:30, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) organizon protestë paqësore para Gjykatës së Apelit në Prishtinë për të kërkuar drejtësi për Donjeta Pajazitin.

Përmes kësaj proteste kërkojmë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë rishqyrtim të drejtë të vendimit të Gjykatës Themelore në Pejë për rastin e të ndjerës Donjeta Pajaziti, si dhe të kërkohet të gjindet dhe të silltet para drejtësisë vrasësi i të ndjerës.

Ju rikujtojmë që e ndjera kishte vdekur në nëntor të vitit 2015, ndërsa i dyshuar kryesor për vrasjen e saj ishte kushëriri Naser Pajazitaj, i cili nga Gjykata Themelore në Pejë u shpall i pafajshëm, në mungesë provash.

Për më shumë informata rreth qëndrimit të RrGK për këtë rast, ju lutemi lexoni kumtesën e plotë që RrGK ka dërguar me 6 mars, në vegzën në vazhdim:

<http://www.womensnetwork.org/documents/20180307102237886.pdf>

Rrjeti i Grave të Kosovës është rrjet i 138 organizatave të ndryshme të të drejtave të grave në gjithë Kosovën që synon të mbrojtë, promovojë dhe mbështesë të drejtat e grave dhe vajzave.